

Udhërrëfyesi i Haxhit


SHTYLLAT E HAXHIT

1. Ihrami
2. Qëndrimi në Arafat,
3. Tavafi i Ifadasë
4. Sa'ji


VAXHIBATET E HAXHIT

Veshja e ihramit në Mikat – Qëndrimi në Arafat derisa të perëndojë dielli - Bujtja në Muzdelife - Bujtja në Mina - Hedhja e gurëve - Rruajtja ose shkurtimi i flokëve - Tavafi lamtumirës

- Ai që e lë një prej shtyllave të haxhit, haxhi i tij nuk vlen pa e kryer atë.
- Ai që e lë ndonjë vaxhib duhet të therë kurban por haxhi i tij është në rregull.
- Për lënie të ndonjë suneti nuk ka mëkat.




WWW.ISLAMHOUSE.COM
WWW.SHEMBULLI.COM




- Është sunnet të shpeshtohen përmendja e Allahut dhe leximi i Kur'anit ditën e Arafatit dhe ditëve të teshrikut në Mina (11, 12, 13 dhul-hixhxe).

- Po ashtu pëlqehen thirrja në rrugën e Allahut, urdhërimi për mirë, ndalimi nga e keqja dhe veprat tjera të mira në këto ditë të bekuara.



Pejgamberi ynë, Muhamedi, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, thoshte: "Shpërblimi i vetëm për haxhin e pranuar është Xheneti."



SHKELJET GJATË IHRAMIT:

Me shkeljet kemi për qëllim ndalesat nga të cilat duhet të largohet haxhiu përderisa ka të veshur ihramin, siç janë:

1. Rruajtja apo shkurtimi i flokëve.
2. Prerja e thonjve pa arsye, qofshin ata të dorës apo të këmbës.
3. Mbulimi i kokës gjatë ihramit.
4. Veshja e muhramit mashkull të rrobave të qepura për tërë trupin apo për një pjesë të tij sikurse këmisha apo seravilet (lloj i pantallonave). Si dhe veshja e rrobave që janë qepur sa masa e një gjymtyre të tij si: mestet, dorëzat apo çorapet.
5. Parfumi: Haxhiut i ndalohet të parfumojë trupin apo rrobat e tij, madje edhe ta përdorë atë në ushqimin e tij.
6. Vrasja e kafshëve të tokës dhe gjuetia e tyre si dhe t'i ndihmojë të tjerëve në gjuetinë apo prerjen e tyre.
7. Lidhja e kontratës martesore për veten e tij apo për të tjerët duke qenë në rolin e kujdestarit apo të ngarkuarit për ta kryer këtë veprim.
8. Lozja me gruan me epsh.
9. Marrëdhëniet intime.

Norma për atë që e vepron një prej ndalesave të Ihramit:

Nëse haxhiu e mbulon kokën e tij, vesh rroba të qepura, përdor parfumin apo gruaja vesh dorëzat, atëherë për shpagim ka të drejtë të zgjedh mes:

1. Agjërimin të tri ditëve.
2. Ushqimit të gjashtë personave të varfër.
3. Prerjes së një deleje.

E nëse e vret gjahun, atëherë për shpagim ka të drejtë të zgjedh mes:

1. Prerjes së një kafshe të ngjashme me të prej bagëtive, nëse ka të ngjashme me të.
2. Ta vlerësojë gjahun me një kafshë të ngjashme me të dhe me vlerën e saj të blejë ushqim për t'i ushqyer të varfrit. Çdo të varfri i jep një "Mud-d" prej grurit apo një gjysmë "Sa'a" prej ushqimeve tjera.
3. Apo agjëron aq ditë sa numri i të varfërve që do t'i kishte ushqyer me vlerën e saj.

E nëse bën marrëdhënie intime:

Kjo është ndër shkeljet më të mëdha gjatë ihramit dhe ndalesa për të është e ashpër. Për këtë shkelje janë dy gjendje:

Gjendja e parë: Nëse bën marrëdhënie para lirimit të parë (Et- Tehal-lul El- Ev-vel) dhe si pasojë e kësaj është:

1. Mëkati.
2. Haxhi i tij priset.
3. Detyrohet ta përfundojë haxhin deri në fund.
4. Detyrohet ta presë një deve dhe mishin e saj t'ua shpërndajë të varfërve të Haremit (Mekës dhe rrethinës së saj të shenjtë).
5. Detyrohet ta kompensojë haxhin vitin e ardhshëm.

Gjendja e dytë: Nëse bën marrëdhënie intime pas lirimit të parë haxhi i tij nuk priset, por detyrohet ta presë një dele.